




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Klan Kosova  
Adriatik Kelmendi  
Drejtor  
Prishtinë



**VENDIM**

**Lidhur me Ankesën nr. 2020/100 – Orange Net (Palë ankuese) kundër  
Klan Kosova (Palë përgjegjëse)**

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 23 nëntor 2020 ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese me pretendimin se në emisionin qendror të lajmeve të orës 20:00 në Palës përgjegjëse të datës 15 nëntor 2020 është transmetuar lajmi: *“se kinse disa operatorë kabllorë janë duke transmetuar Palën përgjegjëse në mënyrë ilegale, duke shfaqur me fotografi dhe me zë llogot e operatorëve, ku një ndër këto llogo ishte e vendosur edhe llogoja e Palës ankuese dhe ky lajm neve na ka shkaktuar shumë dëm të madh pasi që ka shfaqur mosbesueshmëri tek klientët tonë në raport me neve dhe na është dëmtuar shumë imazhi jonë.”*
3. KPM me datën 25 nëntor 2020, përmes një shkrese, e ka njoftuar Palën përgjegjëse për Ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e Palës ankuese.
4. KPM me datën 26 nëntor 2020 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse, përmes së cilës theksohet se pretendimet e Palës ankuese janë tërësisht të pabazuara dhe të paargumentuara. Më tej, në përgjigje theksohet se: *“Ky lajm apo njoftim, nuk ka pasur qëllim shkaktimin e ndonjë dëmi ndaj askujt, por vetëm njoftim për palët se operatorët e apostrofuat nuk kishin marrëveshje valide për transmetim dhe rrjedhimisht ishin duke e transmetuar kanalën tonë në mënyrë ilegale.”*
5. KPM ka analizuar Ankesën e Palës ankuese, ka monitoruar kronikën e lartpërmendur, dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 9 dhjetor 2020 ka gjetur se Pala ankuese

ka hequr dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes me Vendimin e datës 4 shkurt 2020 të Komisionit të KPM-së nr. Ref.2001/116/LIC/ni. Po ashtu, është gjetur se Pala përgjegjëse me transmetimin e atij lajmi ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 10 dhjetor 2020 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra me rastin e shpërndarjes së lajmit të pavërtetë dhe të pa verifikuar për Palën ankuese.
7. KPM me datën 28 dhjetor 2020 ka pranuar Përgjigje nga Pala përgjegjëse përmes së cilës theksohet se pretendimet e Palës ankuese ishin jo të plota dhe të pa qëndrueshme dhe se Pala përgjegjëse nuk ka publikuar informatajto të sakta në asnjë rrethanë dhe të gjitha informacionet ishin konform mbrojtjes së interesave ligjore të Palës përgjegjëse. Po ashtu, në Përgjigjen e tyre kanë theksuar se në Adresarin e publikuar nga KPM-ja, Pala ankuese kishte licencë deri në vitin 2023.

#### Analiza ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 6, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

*“OSHMA duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t'i paraqesin ato në mënyrë që paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë së është i pa vërtetë ose mashtrues.”*


9. KPM bazuar në Raportin e monitorimit, ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të edicionit të lajmeve qendrore me transmetimin e lajmit se Pala ankuese është duke bartur Palën përgjegjëse në mënyrë ilegale ka shpërndarë lajm të pasaktë dhe të pa verifikuar. Pretendimi i Palës përgjegjëse se në Adresarin e publikuar nga KPM-ja figuron emri i Palës ankuese, nuk qëndron, pasi që emri i Palës ankuese nuk gjendet në Adresarin e KPM-së.
10. Komisioni i KPM-së me datë 4 shkurt 2020 ka marrë Vendim që operatorit të shpërndarjes, Palës ankuese, t'ia ndërprejë licencën në bazë të njoftimit të tyre për heqje dorë nga licenca e KPM-së. Që nga viti 2020 Pala ankuese më nuk është operatori i licencuar nga KPM dhe për këtë arsye Pala përgjegjëse me transmetimin e atij lajmi ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
11. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

## Vendim

12. Pala përgjegjëse sanksionohet me *Vërejtje* në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë.

## E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat LATIFI  
Kryetar



28.01.2021  
Datë